



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 257/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Goran Milenković – Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Arf ” Sh.p.k.-Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “Blendi” – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME GRAVURA DHE MIRËNJOHJE PËR NEVOJAT E DKA-së KK-MALISHEVË “ me nr ref 62500-19-2859-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Malishevës, më datën 26.06.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE “Arf ” Sh.p.k.-Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME GRAVURA DHE MIRËNJOHJE PËR NEVOJAT E DKA-së KK-MALISHEVË “ me nr ref 62500-19-2859-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Malishevës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “FURNIZIM ME GRAVURA DHE MIRËNJOHJE PËR NEVOJAT E DKA-së KK-MALISHEVË “ me nr ref 62500-19-2859-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Malishevës, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Arf” Sh.p.k.-Fushë Kosovë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 07.05.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 13.05.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 22.05.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 22.05.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 27.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 28.05.2019.

Operatori ekonomik ankues "Arf" Sh.p.k.-Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2019, me nr. 257/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME GRAVURA DHE MIRËNJOHJE PËR NEVOJAT E DKA-së KK-MALISHEVË" me nr ref 62500-19-2859-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Malishevës, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 11.06.2019, sqaron se Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e ka refuzuar ankesën e OE ankues si të pa bazuar.

I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, OE "ARF" parashtroi ankesë në OSHP për shkelje të dispozitave të LPP-së të lartë cekura në ankesë.

Duke iu referuar pretendimeve ankimore Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankues është plotësisht i bazuar për faktin se AK e ka eliminuar nga konkurrenca pa të drejtë ligjore.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim dhe vendimi për shpërblim të kontratës nga AK, përben shkelje të depozitave të LPP-së, konkretisht nenit 59 dhe 60 të LPP-së, pasi që kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Arsyeje se ofron validitet ofertës më tepër se 30 ditë nuk përben kurrfarë shkelje ligjore sepse rregullat e definojnë qartë se duhet të ipet minimumi i validitetit të ofertave për llojet e kontratave, por nuk e kufizon dhe nuk e trajton validitetin e ofertave më të gjatë se sa është kërkuar.

Eksperti Shqyrtues konsideron se nuk është e drejtë e AK-së që një ofertues të eliminoi nga gara për shkak të ofrimit më të gjatë të validitetit të ofertës se sa kërkohet në njoftim për kontratë.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar nenet si në vijim:

- Nenin 1 –qëllimi
- Neni 51 Kriteret e përzgjedhjes

Nenin 60 Kriteri për dhënie kontratës.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i rekomandon Autoritetit kontraktues aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj dhe me këtë rast i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesën ta aprovoj të bazuar.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Malishevës, përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik “Arf” Sh.p.k.-Fushë Kosovë përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 26.06.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Kocadeklaroj: Ne në momentin e pranimit e leteres standarde për OE te eliminuar dhe ne momentin qe e kemi par arsyen e eliminimit jemi munduar te vërejt atë pik qe na kane eliminuar nga konkurrenca për arsyen qe ka menduar Autoriteti Kontraktues dhe me te njëjtën datë kemi kërkuar një interpretim nga KRPP-ja, lidhur me këtë çështje ku me datën 10.06.2019 kemi marr një përgjigje lidhur me kërkesën qe kemi bere dhe përgjigja ka qen Citoj "Paragrafi ilartpërmendur 31.2 ku e cek vetëm minimumin e validitetit te ofertës pra dhe thotë nëse ju Si OE do te kishit ofruar validitetin nen minimumin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, atëherë kjo do te ishte si shkak për eliminim nga konkurrenca por ne asnjë mënyre jo edhe e kundërta" i dorëzoj panelit interpretimi i KRPP-së, lidhur me validitetin e ofertës, me pranimin e ekspertit jemi pajtuar plotësisht. Poashtu jemi te interesuar edhe nga vet Autoriteti Kontraktues ku ne përgjigjen e kthyer për rishqyrtim si negative thotë qe" ju keni vendosur gabimisht vlefshmërinë e tenderit prej 60 ditësh ndërsa duhet te jetë 30 dite kjo është erregulluar edhe me LPP-në,ne fuqi por ne nuk e dimë për çfarë LPP-së, kanë thënë.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesi AK-së z. Javori deklaroj: Ne nuk jemi pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, ne ligjin ne fuqi qe e tha përfaqësuesi i OE ankues se vlefshmëria e tenderit te procedurat për caktim te çmimeve është 30 dite, ne ligj nuk ceket asnjë dit as me shume e as me pake dhe për këtë është pjesa C e DT-së, ku thotë nëse formulari i tenderit nuk është i plotësuar siç duhet me refuzuar tenderin pa kërkuar sqarime te mëtutjeshme,kjo është arsyeja qe e kemi eliminuar OE-në ankuese.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Kocadeklaroj: Propozoj qe ankesa jone te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe te shpërblehemi me kontrate.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Javori deklaroj: kërkojmë nga paneli qe vendimin e Autoriteti Kontraktues ta len ne fuqi dhe ankesën e OE ankuese ta hedhe poshtë si te pa bazuar

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor,sqaron se Autoriteti Kontraktues KK-Malishevë, lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e ka refuzuar ankesën e OE ankues –"Arf " Sh.p.k.-Fushë Kosovë si të pa bazuar. I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, OE në fjalë parashtron ankesë në OSHP për shkelje të dispozitave të nenit 6, 7, dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtueskonform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar për faktin se autoriteti kontraktues e ka eliminuar nga konkurrenca OE në fjalë pa te drejtë ligjore. Andaj

refuzimi i kërkesës për rishqyrtim dhe vendimi për shpërblim të kontratës nga autoriteti kontraktues, përben shkelje të dispozitave të LPP-së, konkretisht nenit 59 dhe 60 të LPP-së, pasi që kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtueskonform ekspertit shqyrtues sqaron se arsyeje se ofron validitet ofertës me tepër se 30 ditë nuk përben kurrfarë shkelje ligjore sepse rregullat e definojnë qartë se duhet të ipet minimumi i validitetit të ofertave për llojet e kontratave, por nuk e kufizon dhe nuk e trajton validitetin e ofertave më të gjatë se sa është kërkuar, andaj nuk është e drejtë e AK-së, që një ofertues të eliminoi nga gara për shkak të ofrimit më të gjatë të validitetit të ofertës se sa kërkohet në njoftim për kontratë.

Paneli shqyrtuesduke u bazuar në shkresat e lendes të cilat i ka pas në dispozicion si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton seAutoriteti Kontraktues KK-Malishevë, gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektua nenin 1, 51 dhe 60 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues KK- Malishevë, që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitet të prokurimitdhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtijligjiështë tësigurojëmënyrënmëefikase,mëtransparentedhemëtëdrejtë të shfrytëzimittëfondevepublike,burimevepublikesidhetëgjithafondevedheburimevetëtjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetem Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna e Malishevës.

1x1 OE –“Arf” Sh.p.k.-Fushë Kosovë

1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

